



VIT FESTASH, MANIFESTIM I VITALITETIT KOMBËTAR SHQIPTAR

Xhevat Prespa

Sot del një botim mjaft i vecantë nga margjinat e Konferencës shkencore kombëtare: “102 vjet shtet shqiptar e më pastaj - Çështja

shqiptare dhe Derallajt”, e që iu kushtua figurës së Mehmet Pashë Derallës, një nga figurave më të mëdhaja të historisë së re shqiptare. Një ngjarje kjo e shënuar 5 vite më parë dhe një përpjekje për të nxjerr në pah rolin dhe angazhimin e Mehmet Derallës dhe familjes së tij për vendosjen e themeleve të shtetit modern shqiptar, Republikën e Shqipërisë.

Në këtë botim do gjejmë fjalime, diskutime, evokime kujtimesh dhe artikuj shkencor nga autor si: Arsim SINANI, Afrim KRASNIQI, Dorian KOÇI, Bujar DUGOLLI, Darling Ismail VLORA, Ruki KONDAJ, Ibrahim GASHI, Salajdin SALIHU, Romeo GURAKUQI, Valdete DERALLA, Ramë MANAJ, Behxhudin SHEHAPI, Berat (Gajur) DERRALLA, Genc (Avni Ruzhdi) DERALLA, Skender Myrtezani, Nexhat Pilku, Melsi Labi, Ardian Skuka, Ahmed QAZIMI, Zaho GOLEMI, Zeqirja IDRIZI, Hamdi MEDIU, Stephen Edward HARDY, Fitim RIFATI, Eugen SHEHU, Xhelal ZEJNELI, Abdulla MEHMETI, Ermir NIKA, Ismail ARSSLANI, Qerim LITA, Benjamin HASHANI, Ola SHANO, Flogert LILA, Orest RADHIMA, Artan ARSSLANI, Zaho GOLEMI, Aurora GOLEMI, Proletar HASANI, Edit BREGU, Izet ABDYLI, Bernard ZOTAJ, Man POGA, Kastriot I. VESELAJ, Bendis KRAJA, Ilir

ZYLFIU, Haxhi ADEMI, Ndriçim MEHMETI, Skender LUTFIU, Berat MURINA, Bernard ZOTAJ, Asllan ZEMANI, Salajdin SALIHU.

Poashtu në këtë botim mjaft interesante dhe kuptim plotë do të gjejmë një pjesë të botuar për herë të parë të dosjes së Gajur Derallës njëri nga djemtë e Mehmet Derallës. Studimi ka një sërë dokumentesh dhe një foto album që flet për një punë mjaft serioze në sjelljen e fakteve të reja për figurën e Mehmet Derallës, ministrit të parë të luftës në Qeverinë e Vlorës.

E titullova këtë pjesë të shkrimit tim “Vit festash e Manifestim i vitalitetit kombëtar shqiptar pasiqë sivjet shënojmë disa ngjarje me rëndësi për kombin tonë:

550 vjetorin e heroit tonë kombëtarë Gjergj KASTRIOTIT Skëndërbeut;

175 vjetori i Lindjes së Mehmet Derallës;

140 vjetorin e Lidhjes shqiptare të Prizenit;

110 vjetori i Kongresit të Manastirit;

106 vjetori i themelimit të shtetit modern shqiptar Republikës së Shqipërisë;

106 vjetori i Krijimit të Forcave të ushtrisë së Republikës së Shqipërisë;

10 vjetorin e krijimit të shtetit më të ri në Europën juglindore, Republikën e Kosovës.

Vit festash pra, dëshmi se kombi ynë do të ec para. Nuk më mbetet asgjë tjetër vetëm tju uroj lexim të këndshëm të këtyre punimeve që janë një kontribut i vlefshëm për memorien tonë kombëtare. Gëzuar